



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.123/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Kimete Kicaj dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkಿತazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës(PDK), me seli në Prishtinë dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, përkatësisht në drunjë të qytetit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 30.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Pejë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,100.00 (dy mijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë), ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 28.09.2019, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar me fotografi të printuara. Paraqitësi i ankesës potencon se me datën 28.09.2019, në rrugën Isa Demaj në Pejë, monitoruesi i tyre ka hasur në poster të kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), të ngjitura në hapësirat publike, në drunjë të qytetit.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073 dhe konsideron se Partia Demokratike e Kosovës(PDK), ka shkel këtë nen në momentin që ka vendosur posterin e kandidatit në drunjë të qytetit. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës(PDK), të datës 28.09.2019, kanë theksuar se shkelja nuk është e qëllimshme, dhe se kjo është bërë nga aktivistë të painformuar mirë me rregullat zgjedhore, respektivisht me Rregullën Zgjedhore nr.11/2013, neni4.1, (b). Në këtë rast Partia Demokratike e Kosovës(PDK) ka ndërmarr masat e duhura për të përmisuar shkeljen e pretenduar sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë i kanë bashkangjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posterit i kandidati nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), lidhur me rastin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografinë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), dega në Pejë, është vendosur në drunjë të qytetit në rrugën Isa Demaj në Pejë, në hapësira apo vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana Partisë Demokratike të Kosovës(PDK), është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK), janë vendosur në drunjë të qytetit hapësirë publike. Të cilën shkelje e ka pranuar edhe vetë Partia Demokratike e Kosovës(PDK), në përgjigjen në ankesë i datës 28.09.2019.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysht rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysht të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK) ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti se posterie kandidatit nga ky subjekt politik është vendosur në drunjë të qytetit pra në vende apo hapësira publike. Po ashtu si rrethanë, lehtësuese PZAP-i e mori edhe faktin që subjekti politik në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në uljen e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 123/2019 më datën 30.09.2019.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.